Kronikë

# Lëvizte i armatosur në Lungomare të Vlorës, arrestohet 30-vjeçari! I gjendet edhe drogë

*Një 30-vjeçar është arrestuar në Vlorë, pasi u kap me armë zjarri dhe lëndë narkotike gjatë një operacioni policor në zonën e Lungomares.*

Shëtiste me armë me vete në Lungomare të Vlorës, vihet në pran
Report TV

Watch on

Redaksia
1 Gusht, 07:22 | **Përditesimi: 1 Gusht, 10:31**

Share Post

Një 30-vjeçar është arrestuar në Vlorë, pasi u kap me armë zjarri dhe lëndë narkotike gjatë një operacioni policor në zonën e Lungomares.

Në kuadër të operacionit të koduar "Siguria", Policia arrestoi në flagrancë Ergys Omerin, 30 vjeç, banues në Vlorë. Ai u ndalua në parkingun e një lokali në Lungomare.

Gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj tij, në çantën që mbante iu gjetën dhe u sekuestruan një armë zjarri pistoletë me 6 fishekë, 2.18 gramë lëndë e dyshuar narkotike kokainë dhe 4.46 gramë lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa.



LEXO EDHE:
**Vlorë/ Pylli i Sodës 'pushtohet' nga kamperat e çadrat! Të rinjtë europianë: Është eksperiencë e re, larg zhurmës**

> *"Në Vlorë, në kuadër të operacionit policor të koduar "Siguria", u arrestua në flagrancë shtetasi E. O., 30 vjeç, banues në Vlorë. Ai u kap në parkingun e një lokali në zonën e Lungomares, ku gjatë kontrollit fizik në çantën e tij u gjetën dhe u sekuestruan një armë zjarri pistoletë me 6 fishekë, 2.18 gramë lëndë e dyshuar narkotike kokainë dhe 4.46 gramë lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa", njofton Policia.*

-------------------------------

**Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë**

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Ergys Omeri | Vlore | armembajtje pa leje

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 31 Korrik, 15:00
**Reforma territoriale, cili opsion ju pëlqen më shumë?**

46 bashki (PS) | 100 bashki (PD) | 61 bashki (si sot)

## Lajme të tjera



Dy të rinj gjermanë humbin orientimin në Gadishullin e Karaburunit, shpëtohen pas disa orësh kërkime (VIDEO)
1 Gusht, 13:40



'Territorialja'/ Banorët e 15 bashkive që shkrihen, në protesta! Qytetarët në Belsh e Selenicë: Jo reformës që zbraz komunitetet, na largon shërbimet (VIDEO)
1 Gusht, 11:44



'Mos lëviz', momenti kur arrestohen 3 të rinj me 5 kg kanabis! Do i shisnin në Sarandë e Ksamil, njëri 'ruante' lëvizjet e policisë (VIDEO)
1 Gusht, 10:27



Zjarr në Palasë prej mesnatës, ndërhyjnë edhe dy helikopterë (VIDEO)
1 Gusht, 10:10



Harta e re e PS 'shkrin' 15 bashki! Banorët në Klos, Patos dhe Selenicë kundër: Na largoni shërbimet, fshatrat do braktisen
31 Korrik, 15:45



Defekt në sistemin grek, radhë në pikën kufitare të Qafë Botës (VIDEO)
31 Korrik, 11:11



Hyri në zonën e rezervuar duke rezervuar pushuesit, 500 mijë lekë gjobë për drejtuesin e gomones në Ksamil, i bllokohet mjeti lundrues (VIDEO)
31 Korrik, 10:49



Hajdutët përsëritës nga Tirana në Vlorë për të vjedhur banesa, vihen në prangа! Thyen edhe arrestin shtëpiak (VIDEO)
31 Korrik, 10:46



VKM/ 885.500 metra katrorë në Vlorë shpallen zonë e lirë ndërtimi me tarifë 1 euro
30 Korrik, 21:03



Po peshkonte me dinamit, por i shpërtheu në dorë, humb jetën 65-vjeçari në Porto Palermo (VIDEO)
30 Korrik, 12:00



Shpëtohet turisti çek i bllokuar në malin e Çikës, u nxor me helikopter pas 12 orësh operacion (VIDEO+FOTO)
30 Korrik, 11:41



Me pushime në Vlorë, arresti kardiak i merr jetën ish volejbollistit dhe ish trajnerit Artan Pogoni
Armand Xhelili
28 Korrik, 17:49







Lajmi i fundit



**U kap duke shitur drogë, pranga 23-vjeçarit në Genova! I gjenden 12 doza kokaine të fshehura te të brendshmet**
1 Gusht, 20:25



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit



**U kap duke shitur drogë, pranga 23-vjeçarit në Genova! I gjenden 12 doza kokaine të fshehura te të brendshmet**

1 Gusht, 20:25

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com